

VENDIM
Nr. 87, datë 24.4.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 129, SERIA PV11K, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “SELISHTË” SHPK

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 5, germa “ç”; 6 dhe 7 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 6.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.4.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1246/3 prot., datë 14.4.2025, të përgatitur nga grupi i punës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitoare ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit të vitit 2024”, konstatoi se:

- Shoqëria “Selishte” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 129, seria PV11K, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 60, datë 22.6.2011.

- Me vendimin e bordit nr. 83, datë 2.5.2024, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2024 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 83/2024 është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 86, datë 21.5.2024. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1237 prot., datë 28.5.2024.

- Nga verifikimi administrativ rezulton se shoqëria “Selishte” sh.p.k. nuk ka kryer pagesën e detyrimit rregullator për vitin 2024.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 47, datë 4.3.2025, është ngritur grupi i punës për zhvillimin e hetimit administrativ dhe marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të vitit 2024 të pashlyera ndaj ERE-s.

- Me shkresën nr. 1335 prot., datë 13.3.2025, i është njoftuar subjektit çelja e hetimit administrativ, duke i lënë afat 5 ditë për të paraqitur shpjegime dhe dokumentacion shoqërues, në lidhje me statusin e shlyerjes së detyrimit. Kjo shkresë është dërguar, gjithashtu, me *e-mail* më datë 17.3.2025.

- Subjekti “Selishte” sh.p.k. nuk ka paraqitur shpjegime dhe nuk ka kryer pagesën, si dhe nuk ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83/2024.

1. Vlerësimi i shkeljes dhe parashikimet ligjore:

- Mosshlyerja e pagesës së rregullimit për vitin 2024 përbën shkelje të dispozitave të neneve 42, germa “ç”, dhe 107 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, i cili parashikon, se: ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji; si dhe për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj.

- Në rastet kur subjektet nuk kanë zhvilluar aktivitetet dhe nuk kanë të ardhura për vitin paraardhës, në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave të rregullimit, aplikohet një tarifë fikse dhe për këto raste nuk mund të kalkulohet masa e gjobës.

2. Përputhshmëria me rregulloren për heqjen e licencës:

- Në përputhje me nenet 5 dhe 6 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, subjekti ndaj të cilit ka filluar procedura për heqjen e licencës mbetet përgjegjës për shlyerjen e të gjitha detyrimeve të pashlyera ndaj ERE-s.

- Sipas nenit 7 të kësaj Rregulloreje, subjekti i licencuar ka të drejtë të japë përgjigje me shkrim brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

3. Masat e mëtejshme dhe dispozita mbështetëse:

- Nisur nga parashikimet e ligjit nr. 43/2015 dhe të rregullores përkatëse, vlerësohet se, për të siguruar trajtim të barabartë për të gjitha subjektet që kanë kryer të njëjtën shkelje (mosshlyerje të pagesës së rregullimit), ndaj shoqërisë “Selishte” sh.p.k. duhet të vijohen procedurat për heqjen e licencës.

- Nëse heqja e licencës do të prekë aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, duhet ndjekur procedura e parashikuar në nenin 42, pika 3 të ligjit nr. 43/2015, për marrjen e masave të përkohshme për administrimin e aseteve për sigurinë e furnizimit të konsumatorëve, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 129, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Selishte” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 60, datë 22.6.2011.

2. I licencuari ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë shoqërinë “Selishte” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti